



## **Albsig, pjesmarrëse në Ditën e Karrierës 2018. “Hidh Hapin Tënd”**

Dita e Karrierës 2018. "Hidh Hapin Tënd". Event ky i organizuar nga Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës zhvilluar me dt. 19 prill 2018. Në panairin e “Ditës së karrierës”, më shumë se 60 kompani të cilat ekspozuan ofertat e punës në Fakultetin e Ekonomisë, ku mes tyre ishte dhe Albsig pjesë e Kastrati Group. Shoqëria jone gjithmone është spikatur si mbështetëse e brezave të rinjë në rrugën e Karrierës. Kompanitë e pranishme në event ekspozuan ofertat mbi praktikën mësimore, internshipet, mundësitë e punësimit, trajnimet dhe workshopet. Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj punëkërkuësve të rinjë, me dëshirë për të mësuar dhe për të zhvilluar edhe më tej aftësitë personale dhe profesionale, duke u dhënë hapësirën e kërkuar për të përfituar sadopak eksperiencë në fushën e sigurimeve. Shoqëria e Sigurimeve Albsig ofron mjedisin e duhur për zhvillimin profesional dhe mundësinë e aplikimit të aftësive për profesionistët njëkohësisht mbështet shumë fort dhe brezin e ri të studenteve. Stenden e Albsig e vizituan dhe aplikuan rreth 90 studente ku shumica prej tyre përveç kërkesave për internshipet kërkuan dhe mundësi punësimi dhe praktikimi. Në kuadër të mbështetjes së studenteve pjesëmarrës në panairin “Dita e Karrierës” Albsig, 10 prej studenteve me të mirë pjesëmarrës në panair u mundësoi internshipin pranë departamenteve përkatëse.

## **Event/ Shoqata e Siguruesve: Tregu i Sigurimeve bashkëbisedon me Mediat**

“Tregu i Sigurimeve bashkëbisedon me mediat”, kështu është titulluar takimi i realizuar nga Shoqata e Siguruesve me mediat dhe Shoqëritë e Sigurimeve. Shoqatat e sigurimeve në një bashkëbisedim me mediat evidentoi sfidat me të cilat tregu i sigurimeve përballë sot. Edvin Libohova, në emër të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë deklaroi se ky event është i rëndësishëm në 15 vjetorin e krijimit të kësaj shoqate. Ndergjegjësimi i mediave dhe njohja me produktet vullnetare të sigurimeve, kanë qenë disa nga synimet e tjera të takimit të realizuar në qytetin e Durrësit. Plarent Hamzaj, zv. Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.sh.a, bëri të mundur njohjen e pjesëmarrësve me sigurimin e pronës problematikat dhe novojat që ka tregu për sigurimet e pronave. Si dhe rolin që luan media në ndergjegjësimin e bizneseve për pajisjen e pronave tyre me sigurim.

## **Albsig sh.a, sponsor mbështetës i koncertit “Hapësira e një ëndrre”, të kengetarit të mirënjohur Alban Skenderaj**

Albsig sh.a mbështet ëndërrat e shkrimtareve, këngëtareve, dhe të rinjëve të çfarëdo lloji profesioni që ata kanë. Albsig është kudo me produkte dhe shërbime gjithashtu përkrah çdo kënd që jep një mesazh jetësor. “Hapësira e një ëndrre” nuk është thjesht titulli i një koncerti, por kënga që ka pagëzuar karrierën muzikore të këngëtarit Alban Skenderaj 15 vite më parë. Koncerti sipas tij është një projekt

sfidues në përgjithësi jo vetëm artistikisht, por edhe historikisht i cili ka pas një sere sponsor mbështetes, ku ndër to është dhe Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group. Koncertin u realizua në datën 2 mars në Pallatin e Kongreseve shoqëruar nga mbi 65 orkestrantë të orkestrës simfonike të RTSH e cila u drejtua nga Gridi Kraja. Koncerti i konceptuar në stilin Alban&Friends dhe një koncert pop-klasik ngërthen edhe disa surpriza, por zbulon edhe anën modeste të karakterit të Alban Skenderajt se si e përjeton ai suksesin e përseritjes së koncertit për 3 mbrëmje rresht. Ne njerëz prej neteve të transmetimit të koncertit të kengetarit moren pjesë dhe stafi i Albsig. Andaj Albsig, duke dashur të promovojë dhe mbështesë trashëgiminë kulturore dhe sidomos kengetaret e mirefillte shqiptare është gjithmonë mbështetes i eventeve të tilla.

### **Albsig mbështet shkrimtarët e rinj**

Për disa vite me radhë, Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group është sponsor dhe mbështetes i shkrimtareve të njohur dhe të rinj. Shkrimtarët e rinj me veprat e tyre si në fushën e letrarisë ashtu dhe në ato të historisë me përmbajtjen e tyre ndërtojnë një lidhje mes anës shpirtërore dhe asaj reale të njeriut dhe e afirmojnë mendimin kulturor, historik . Motivi kryesor për përfshirjen në këto projekte është që shkrimtareve të njohur dhe të rinjve me nevojën të veçantë t'u mundësojë zhvillimin e një frymë të shëndetshme dhe aftësi krijuese, për tu edukuar dhe integruar plotësisht në rrymat letrare që ata përfaqësojnë. Vazhdimi i bashkëpunimit me Shkrimtarët dhe mbështetja e këtyre projekteve konfirmon përpjekjet Albsig për një qasje afatgjatë dhe sistematike për të përmirësuar mirëqenien e grupeve të pambrojtura në komunitet dhe është në përputhje me angazhimet strategjike të Albsig në fushën e përgjegjësisë sociale. Në të gjithë besojmë në një të ardhme më të mirë, por shikimi në të ardhmen nënkupton pranimin e përgjegjësisë për atë që po ndodh sot në shoqëri, për të nxitur ndryshimet, si në sektorin tonë profesional, ashtu edhe në komunitetin në përgjithësi. Qëllimi i çdo kompanie dhe çdo individi është të jetojë në harmoni me vetveten dhe me mjedisin e tij. Prandaj është e nevojshme të jetë përgjegjës për çdo veprim dhe vendim, profesional dhe personal. Në kuadër të mbështetjes së zhvillimit të mëtejshëm të artit dhe kulturës Albsig thuhet për çdo vit mbështet si sponsor shkrimtarët e rinj.. Këtë vit ndryshe nga vitet e tjera mbështet shkrimtarin dibran z. Sakip Cami me librin e tij të fundit mbi hulumtimet që ai ka bërë në zonën e Dibres për heronjtë e padegjuar të asaj zone. Hulumtime historike dhe fakte reale të pathëna ndonjëherë do të jenë ekskluzive në librin e ri i cili del në treg këtë periudhë.

### **Albsig sponsor kryesor për Festivalin e Filmit Ballkanik Pogradec**

Albsig mbështet dhe zhvillimet në fushën e kinematografisë. Këtë vit më dt. 2 dhe 7 korrik në qytetin e Pogradecit është zhvilluar Festivali i Filmit Ballkanik dhe të Kulinarisë në Kinemanë "Lasgush Poradeci" në Pogradec. Ky event është realizuar për të distain vit në këtë qytet dhe kanë marrë pjesë kineaste jo vetëm nga Shqipëria por nga e gjithë Ballkani. Festivali ka zgjatur për një periudhë kohe 1- javore ku specialistët e kësaj fushe kanë mundur të shfaqin jo vetëm risite por edhe problematikat që mbart kjo fushe. Ajo është vlerësuar dhe me shumë ishte dhe fusha e kulinarisë e cila është mirepritur jo vetëm nga evndasit por dhe nga atë ardhurit nga qytete të ndryshme të Ballkanit.

## **Albsig me brand të ri**

Shoqëria e Sigurimeve Albsig sh.a nën hapin e kohës vjen me brand të ri. Logoja ose emblema e re e Albsig, e propozuar dhe stilizuar për një stad të ri, siguron një burim avantazhi konkurrues duke integruar vizionin e kompanisë, kulturën dhe vlerat, me sistemet dhe rrjetet organizacionale me qëllim formimin e një vlere unike për tu përfaqësuar tek konsumatorët.

Logoja e shoqërisë ka një trashëgimi të pasur, asete dhe aftësi, njerëz, vlera dhe prioritet, elemente referenciale lokale dhe rajonale, programe që lidhen me qytetarët dhe regjistrat të performancave historike. Duke ruajtur konturet e logos së mëparshme, simbolika e logos së re është bërë e thjeshtë për t'u fiksuar dhe për të ngjatur në mendjen e konsumatorëve.

Janë ruajtur me delikatese elementet vizuale nga brandi i vjetër në mënyrë që të mos largohet shumë nga preceptimi i publikut. Konkretisht është ruajtur emri, **ALBSIG** dhe ngjyra e logotipit të mëparshëm. Meqenëse Albsig është pjesë e Kastrati Group, logoja e së cilit është përkrenarja e heroit kombëtar Skënderbeut, është paraqitur një logo e cila, tregon vlerat, fuqinë, krenarinë, dhe vetëbesimin ndaj konsumatorëve dhe jo vetëm. Ndryshimi i logos së ALBSIG, është pjesë e strategjisë për përshtatjen e të gjithë imazhit, me cilësinë e shërbimeve që ne ofrojmë. Pas, 14 vitesh që operojmë në treg, jemi zhvilluar dhe kemi përmirësuar ndjeshëm gamën dhe cilësinë e produkteve dhe jemi në një pikë ku renditemi ndër kompanitë më prestigjioze e më të besuarit në vend e në rajon.

## **Albsig mbështet Shoqatën e Arberesheve Vorea për një udhëtim turistik në Shqipëri**

Rrugëtimin të gjatë të arberesheve të Shoqatës Vorea dhe Qendrës Albania Excellencë, për të festuar vitin e Skënderbeut në Shqipëri ju bashkua dhe Albsig, pjesë e Kastrati Group. Shoqëria e Sigurimeve Albsig si mbështetëse e njerëzve të artit dhe të trashëgimisë historike e kulturore, ishte pjesë e aktivitetit të zhvilluar në nder të vitit të Skënderbeut, këtë herë ndryshe, në një rrugëtim "historik" nga dt. 01 deri me 06 maj në Shqipëri, një udhëtim në vendet ku ka luftuar Gjergj Kastrioti Skënderbeu Heroi Kombëtarë, nga Kalaja e Petrelës, në fushën e Domosdovës, në fushën e betejës së Vajkalit, deri në Sinën e largët ku lindi Heroi ynë.